



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**

**KUVENDI**

***Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike  
dhe të Drejtat e Njeriut***

*Dokument parlamentar*

**PROCESVERBAL**

Datë 18.11.2014, ora 09:00

**Drejton mbledhjen**

**Fatmir Xhafaj – kryetar i Komisionit**

**Rendi i ditës:**

1. Shqyrtimi nen për nen i projektligjit “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9975, datë 28.07.2008 “Për taksat kombëtare”, të ndryshuar””.
2. Diskutimi i projektbuxhetit të vitit 2015 për Presidencën.
3. Shqyrtimi nen për nen i projektligjit “Për buxhetin e shtetit të vitit 2015”.
4. Projektvendimi për miratimin e strukturës dhe organikës së Komisionerit të Mbikëqyrjes së Shërbimit Civil.

**Marrin pjesë:**

Fatmir Xhafaj, Blendi Klosi, Armando Subashi, Bashkim Fino, Ulsi Manja, Xhemal Qefalia, Petrit Vasili, Dashamir Peza, Spartak Braho, Armando Prenga, Vasilika Hysi, Pandeli Majko, Pirro Lutaj, Nard Ndoka dhe Tahir Muhedini.

**Mungojnë:**

Oerd Bylykbashi Gent Strazimiri, Fatmir Mediu, Edi Paloka, Mhill Fufi, Eduard Halimi, Kastriot Islami, Keltis Kruja, Mark Frroku, Vexhi Muçmataj, Gjovalin Bzheta, Arben Ristani, Silva Caka dhe Tom Doshi.

**Të ftuar:**

Ervin Mete – zëvendësministër i Financave

Gelardina Prodani - sekretare e Përgjithshme në Ministrinë e Financave

Mimoza Dhëmbi - drejtore e Përgjithshme e Buxhetit në Ministrinë e Financave

Gentian Opre – drejtor në Drejtorinë e Programimit Buxhetor

Arjana Dymishi – Drejtore në Drejtorinë e Politikave dhe Marrëdhënieve Fiskale

Vilma Causholli – përfaqësuese nga Ministria e Financave

Pranvera Strakosha – Komisionere e Mbikëqyrjes së Shërbimit Civil

Enkela Dudushi – përfaqësuese e DAP-it

## HAPET MBLEDHJA

**Fatmir Xhafaj** – Mirëmëngjesi!

Fillojmë mbledhjen e komisionit.

Si pikë të parë kemi shqyrtimin nen për nen të projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9975, datë 28.07.2008 “Për taksat kombëtare të ndryshuar””.

Për të fituar kohë sa të vijë përfaqësuesit e Presidencës.

Neni 1. Ka ndonjë gjë për nenin 1?

Të gjithë dakord.

Neni 2. Zoti Fino.

**Bashkim Fino** – Në pikën 2, shkronja “b”, është fjalia “të ardhurat nga renta minerare përdoren për investime për njësitë e qeverisjes vendore”. Cili është kuptimi i kësaj që po them unë? Renta minerare thamë përfundimisht që do të jetë në funksion të pushtetit vendor në 5%. Në momentin që ti ua jep organeve të pushtetit vendor, natyrisht që ti me nenin 15 të projektbuxhetit ia ke dhënë klauzolën se sa do të përdorë për pagat, sepse i thua që në kaq banorë, kaq për qind do të përdoret nga granti i pakushtëzuar për shpenzimet administrative.

Kjo do të thotë se ky 5% i rentës për investime do të shkojë edhe për shërbime. Pse e cilëson me këtë fjalinë që ky 5% do të përdoret për investime? Ajo për investime do të shkojë, sepse pagat ata i kanë marrë me nenin 15 të ligjit të buxhetit të shtetit. Duke i thënë këtë gjë që të ardhurat shkojnë për investime, ia cilëson. Kjo mua më duket e tepërt dhe e vënë në mënyrë të gabuar.

Po i bëj një pyetje drejtoreshës së Buxhetit, nuk po i them zëvendësministrit. Ka mundësi që ky fond, kjo renta minerare të shkojë për rrogat? S’ka mundësi, sepse në nenin 15, ia ke caktuar se sa do t’i ketë pagat?

*(Diskutime pa mikrofon)*

Ju lutem, më ktheni një përgjigje.

**Fatmir Xhafaj** – Zoti zëvendësministër!

**Ervin Mete** – Në koncept shpërndarja e rentës për pushtetin vendor jepet për të adresuar ato ekstrenalitet apo efekte negative që mund të vijnë nga industritë nxjerrëse dhe

është menduar që të adresohen këto ekstrenalitete nëpërmjet investimeve, pra të mos shkojnë për paga, shpërblime, trajnime e me radhë. Mendojmë që është e shëndetshme dhe jo e dëmshme.

Faleminderit!

**Fatmir Xhafaj** – Faleminderit.

Vazhdojmë me ...

*(Mungesë incizimi)*

Me zotin Fino. E tha përgjigjen. Ministria, qëndron propozimi i zotit Fino?

Do ta sqarojmë më vonë. Të biem dakord me propozimin e zotit Fino që t’ia çojmë Komisionit të Ekonomisë.

Dakord!

Neni 3. Të gjithë dakord.

Neni 4. Dakord.

Neni 5. Dakord.

Neni 6, “Hyrja në fuqi”. Dakord.

Pra, të gjithë janë dakord në tërësi me ligjin, me vërejtjet që u bënë.

Miratohet.

**Fatmir Xhafaj** – E votova.

**Bashkim Fino** – Te neni 5, në pikën 1, shkronja “b”, është i paraprirë formulimi “përkohësisht brenda 1 viti kalendarik”, por nuk thotë kohën, pasi nuk përcaktohet periudha, thonë këshilltarët e komisionit, duhet të rregullohet kjo.

Është thjesht një rregullim shkrimi, nuk ndryshon gjë në koncept si nen.

Çdo të thotë vit kalendarik? Kur fillon, kur mbaron, nuk ka afat. Përkatësisht një herë brenda një viti kalendarik. Po cili është viti kalendarik? Kjo gjë duhet të zgjidhet.

**Fatmir Xhafaj** – Jemi dakord me vërejtjet e bëra.



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**

**KUVENDI**

***Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike  
dhe të Drejtat e Njeriut***

*Dokument parlamentar*

**PROCESVERBAL**

Datë 18.11.2014, ora 09:00

**Drejton mbledhjen**

**Fatmir Xhafaj – kryetar i Komisionit**

**Rendi i ditës:**

Diskutimi i projektbuxhetit të vitit 2015 për Presidencën.

**Marrin pjesë:**

Fatmir Xhafaj, Blendi Klosi, Armando Subashi, Bashkim Fino, Ulsi Manja, Xhemal Qefalia, Petrit Vasili, Dashamir Peza, Spartak Braho, Armando Prenga, Vasilika Hysi, Pandeli Majko, Pirro Lutaj, Nard Ndoka dhe Tahir Muhedini.

**Mungojnë:**

Oerd Bylykbashi, Gent Strazimiri, Fatmir Mediu, Edi Paloka, Mhill Fufi, Eduard Halimi, Kastriot Islami, Keltis Kruja, Mark Frroku, Vexhi Muçmataj, Gjovalin Bzheta, Arben Ristani, Silva Caka dhe Tom Doshi.

**Të ftuar:**

Arben Idrizi – sekretar i Përgjithshëm në Presidencë

Arti Çiçolli - drejtori i Planifikim-Menaxhimit në Presidencë

**Fatmir Xhafaj** - Kalojmë në diskutimin e projektbuxhetit 2015 për Presidencën.

Kanë ardhur përfaqësuesit e Presidencës?

Përfaqësues nga Presidenca kemi sekretarin e Përgjithshëm dhe drejtorin e Planifikim-Menaxhimit.

Vazhdojmë me seancën dëgjimore për institucionin e Presidencës në vazhden e të gjitha institucioneve që kemi dëgjuar. Kemi njoftuar javën e kaluar, më saktë ditën e premte, meqenëse kishte një kërkesë nga kabineti i Presidencës së Republikës, për t'u dëgjuar për buxhetin. Sot është këtu sekretari i Përgjithshëm bashkë me pjesën tjetër të stafit, lidhur me paraqitjen e projektbuxhetit me komente apo kërkesa të ndryshme që mund të keni për projektbuxhetin.

Për ne projektbuxheti është i njohur. Në mënyrë të përmbledhur, cili është komenti juaj dhe pretendimi që keni?

**Arben Idrizi** – Të nderuar anëtarë të Komisionit të Ligjeve,

Shkurtimisht do t'ju paraqes opinionin tonë për projektbuxhetin për sa i përket shumës që mendohet t'i akordohet institucionit të Presidentit të Republikës. Në buxhetin e vitit 2014 institucionit tonë i janë akorduar 183,2 milionë lekë në total, ndërkohë që për vitin 2015 është parashikuar një shumë prej 177 milionë lekësh me një diferencë prej rreth 3,4% më pak në vitin 2015 në krahasim me vitin 2014.

Po kështu për zërin “shpenzime të tjera operative”, në buxhetin e vitit 2015 është parashikuar një ulje prej 8,5%. Gjatë vitit 2014 janë kryer edhe shpenzime të paparashikuara, siç ishte rasti i vizitës së Papa Françeskut në vendin tonë, ku gjatë asaj kohe, pra gjatë përgatitjes së vizitës, i kemi kërkuar Ministrisë së Financës fonde shtesë për shpenzimet e kryera dhe të faturuara për të cilat ende jemi në pritje. Siç jeni në dijeni, edhe për vetë natyrën e specifikën e institucionit, në përmbushjen e funksioneve kushtetuese të Presidentit të Republikës në veprimtarinë e tij brenda dhe jashtë vendit në arenën ndërkombëtare, dalin vazhdimisht aktivitete shumë të rëndësishme dhe të paparashikuara, të cilat duhen ndjekur me vëmendje maksimale. Për shembull, gjatë vitit 2015 kemi rastin e Presidencës Shqiptare në SECP, ku në përmbysje të këtij 1-vjeçari të Presidencës Shqiptare, diku nga mesi i vitit 2015 do të organizohet Samiti i Krerëve të Shteteve të këtij organizmi, ku institucioni i Presidentit të Republikës ka rolin organizator, është primar në organizimin e këtij aktiviteti dhe buxheti që është planifikuar deri më sot nuk e mundëson një organizim serioz të këtij aktiviteti.

Gjithashtu viti 2015 përkon edhe me 25-vjetorin e rënies së komunizmit në vendin tonë dhe institucioni i Presidentit të Republikës ka parashikuar organizimin e ceremonive, me pjesëmarrjen e personaliteteve të shquara ndërkombëtare, ku gjithashtu edhe për organizimin e këtyre aktiviteteve buxheti i alokuar për vitin 2015 nuk e bën të mundur realizimin e tyre.

Në momentin e hartimit të projektbuxhetit të vitit 2015 ne i kemi kërkuar Ministrisë së Financës dhe Ministrisë së Ekonomisë, kemi pasur edhe takime disa herë me përfaqësuesit e tyre, edhe një shtesë në fondin e investimeve, përkatësisht në shumën 12 milionë për rinovimin e sallave ku zhvillohen aktivitetet kryesore në institucionin e Presidentit dhe një shumë prej 15 milionësh për investime për blerjen e automjeteve për Presidentin e Republikës.

Faleminderit!

**Fatmir Xhafaj** – Faleminderit!

Mund të na i përmbledhësh me 2-3 fjali. E para, për shpenzime korente, për shpenzime operative, sipas gjuhës së Mozës, sa është shuma që kërkohet, dhe sa është për investime?

**Arben Idrizi** - Për shpenzimet operative është 13 milionë lekë. Për investime janë rreth 27 milionë, por gjatë bisedimeve që kemi pasur me përfaqësuesit e Ministrisë së Financave dhe të Ekonomisë na është kërkuar që cilin nga këta dy zëra keni prioritarë, dhe ne kemi thënë që prioritare është rinovimi i sallës së institucionit.

**Fatmir Xhafaj** – Sa është shuma për këtë?

**Arben Idrizi** – 12 milionë.

**Fatmir Xhafaj** – Faleminderit!

Zoti Fino.

**Bashkim Fino** – Faleminderit!

Duke falënderuar sekretarin e Përgjithshëm të Presidencës, është normale dhe këto shifra janë siç tha ai, e vërtetë, por le të themi që nuk kemi ndryshim në paga dhe sigurime shoqërore, nuk kemi ndryshim në mallra dhe në shërbime, jemi korrektë, kemi një diferencë në shpenzimet operative siç u tha nga 178,2 milionë në vitin 2014 me 171,5 milionë lekë në vitin që vjen dhe kjo ka ardhur vetëm për shkak të bonusve që kanë marrë në vitin 2014, e cila është 6,7 milionë. Këto me vendim qeverie me ligj janë hequr të gjitha, në mos gaboj dhe absolutisht Ministria e Financave nuk ka bërë gjë tjetër vetëm ka zbritur shumën 6,7 milionë. Ndaj këtu rezulton 178,2 milionë në vitin 2014 me 171,5 milionë në vitin 2015, pra duke hequr bonuset që

u janë hequr të gjithëve, me deputetë, ministra, të cilat janë hequr me ligj, rezultojnë këto shifra që do të thotë që në shifra teknike nuk ka asnjë lloj ulje, kemi zbatuar ligjin.

**Fatmir Xhafaj** – Pra, në qoftë se do të ishin bonuset, kjo do të ishte siç ishte.

**Bashkim Fino** – Absolutisht, po të ishin bonuset, do të ishim në rregull. Të jemi të sinqertë të flasim siç duhet. Vijmë te kërkesat reale që Presidenca paraqet. Paraqet këtu disa shpenzime operative për shkak të aktiviteteve që ka, siç i thanë këtu, është e planifikuar një vlerë prej 5 milionësh investime për vitin 2015 dhe, me sa duket, ky 5 milionëshi nuk i bën shumë punë, sepse kanë dy objektiva kryesore, qoftë rinovimin e sallave, qoftë për automjetet. Unë mendoj, zoti kryetar, që të dyja këto kërkesa mund të shikohen, t'i mbajmë shënim, të mund të adresojmë pranë Komisionit të Ekonomisë ne si komision përgjegjës për të rregulluar vërtet atë që është dhe atë që kanë negociuar Presidenca me Ministrinë e Financave për ta zgjidhur problemin, e para.

Për çështjen e investimeve unë jam plotësisht dakord, që nga 5 mund të bëhet deri në 12 për të bërë rinovimin e sallave, për të bërë një investim vërtet dinjitoz, sepse tregon kulturën dhe prezantimin e shtetit tonë në çdo lloj takimi që bën Presidenca.

Ndërsa për sa u përket shpenzimeve operative, do të doja vërtet mendimin e specializuar të Ministrisë së Financave, në qoftë se i qëndrojmë logjikës që unë sapo fola për bonuset që janë hequr, do të thotë që nuk kemi arsye pse të shtojmë, por në qoftë se ne kemi mundësi të shtojmë diçka, absolutisht unë jam shumë i hapur që të negociojmë për të shtuar ndonjë gjë që mund të na ketë shpëtuar me shpenzimet operative.

Propozimi im, zoti kryetar, është që investimet le të bëhen 12 milionë ashtu siç është kërkuar për të bërë rregullimin e sallave dhe të shikohet mundësia mbi bazën e këtyre të dhënave që kemi të vitit 2015, në qoftë se kemi mundësi të shtojmë në zërin e shpenzimeve operative për ato aktivitete që ka Presidenca për vitin e ardhshëm nga 13 të paktën, të mund të shtojmë dhe 6 ose 7 milionë të tjera ta zgjidhim këtë çështje.

Këto dy propozime që kisha unë, u futa si e mesmja e artë midis propozimeve të Presidencës dhe atyre që ne kemi mundësi të bëjmë te Komisioni i Ekonomisë. Nuk e di në qoftë se ngelën të kënaqur përfaqësuesit e Presidencës, në qoftë se kanë ndonjë gjë ta thonë prapë.

**Fatmir Xhafaj** – Me sa kuptoj unë, që ta përmbyll, është propozimi i relatorit, ku ne biem dakord që të ketë 12 milionëshin e domosdoshëm për investime, për shpenzime operative

që lidhen me cilësinë e punës normale, me ushtrimin e detyrës së Presidentit, që janë të domosdoshme, kurse pjesa që mbetet, që janë për aktiviteve të mëdha kombëtare dhe investimet që lidhen me to, të cilat janë pak specifike, le t'i shikojë gradualisht buxheti i shtetit gjatë vitit, sepse ka mundësi që qeveria, siç bën për institucionet e tjera, le të bëjë edhe për institucionin e Presidencës me rezervën që përdor etj.

Në qoftë se biem dakord, është goxha rritje dhe nuk do të ketë më shumë nevojë për komente.

Mos u sqaro se jek e jek jeni, në qoftë se do të hiqet kjo apo jo sepse si financier e tha zoti Fino.

**Arti Çiçolli** – Në kushtet reale mbi buxhetin faktik ai 6 milionësh vërtet është hequr nga bonuset, por është futur te mallrat në shërbim. Pra, atë që është shfrytëzuar nga Ministria e Financave është kaluar te mallra dhe shërbime dhe ne e kemi pasur disponibël, pra mallrat e shërbimit nga 72 kanë shkuar në 78.

Pika e dytë që doja të shtoja është për aktivitetet që do të jenë gjatë vitit dhe besoj që edhe një vit përpara kemi qenë në po të njëjtin pozicion dhe kemi marrë të njëjtin angazhim që në momentin që do të ketë një aktivitet do të suportoheshim, por ende jemi në pritje të një 3 milionëshi nga Ministria e Financave për vizitën e Papa Françeskut. Kam frikë se përsëri mos dalim tek i njëjti përfundim.

**Fatmir Xhafaj** – Po e marrim kaq shumë nëpër gojë atë vizitën, se nuk është mirë. Njëri del andej thotë u shpenzua kështu, e tjetri gjë tjetër. Le ta mbyllim atë histori. Ishte një ngjarje shumë e madhe.

Po, përfaqësuesi i Ministrisë së Financave.

**Geraldina Prodani** – Në vijim të diskutimit dhe të vendimmarrjes suaj, edhe unë dua të mbështes pikërisht këtë logjikë që Ministria e Financave zakonisht jep buxhet për aktivitetin normal për të kryer funksionet bazë të institucioneve dhe për aktivitete specifike i mbështet nëpërmjet fondit rezervë, siç është edhe rasti i vizitës së Papës për të cilin ne kemi marrë preventivën e saktë nga Presidenca dhe kemi përgatitur vendimin e qeverisë, pra është gati për t'u miratuar në qeveri. Po kështu mund të veprojmë edhe me aktivitetet e tjera.

**Fatmir Xhafaj** – Kjo vjen sepse ju nuk keni komunikim të mirë. Duhet të rregulloni komunikimin, Ministria e Financave me stafin e Presidentit. Edhe ata ta marrin këtë si një

vërejtje që duhet të komunikojnë më mirë me ju, por edhe ju duhet të komunikoni më mirë me ta dhe pastaj krijohet një zhurmë e madhe, sikur presidenca, qeveria, zmadhohen gjërat atje ku nuk janë.

Biem dakord, zoti Idrizi?

Kolegë, jeni dakord me propozimin e relatorit që t'ia kalojmë Komisionit të Ekonomisë.

Faleminderit zotërinjve dhe zonjës së Presidencës!

Punë të mbarë!

Besoj se u mirëkuptuam si edhe vitin e kaluar në këtë komision.



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**

**KUVENDI**

***Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike  
dhe të Drejtat e Njeriut***

*Dokument parlamentar*

**PROCESVERBAL**

Datë 18.11.2014, ora 09:00

**Drejton mbledhjen**

**Fatmir Xhafaj – kryetar i Komisionit**

**Rendi i ditës:**

Shqyrtimi nen për nen i projektligjit “Për buxhetin e shtetit të vitit 2015”.

**Marrin pjesë:**

Fatmir Xhafaj, Blendi Klosi, Armando Subashi, Bashkim Fino, Ulsi Manja, Xhemal Qefalia, Petrit Vasili, Dashamir Peza, Spartak Braho, Armando Prenga, Vasilika Hysi, Pandeli Majko, Pirro Lutaj, Nard Ndoka dhe Tahir Muhedini.

**Mungojnë:**

Oerd Bylykbashi Gent Strazimiri, Fatmir Mediu, Edi Paloka, Mhill Fufi, Eduard Halimi, Kastriot Islami, Keltis Kruja, Mark Frroku, Vexhi Muçmataj, Gjovalin Bzheta, Arben Ristani, Silva Caka dhe Tom Doshi.

**Të ftuar:**

Ervin Mete – zëvendësministër i Financave

Gelardina Prodani - sekretare e Pergjithshme

Mimoza Dhembli - drejtore e Pergjithshme e Buxhetit

Gentian Opre – drejtor në Drejtorinë e Programimit Buxhetor

Arjana Dymishi – Drejtore në Drejtorinë e Politikave dhe Maredhenieve Fiskale

Vilma Causholli – përfaqësuese nga Ministria e Financave

Pranvera Strakosha – Komisionere e Mbikqyrjes se Shërbimit Civil  
Enkela Dudushi – përfaqësuese e DAP-it

**Fatmir Xhafaj** – Vazhdojmë me shqyrtimin nen për nen të projektligjit “Për buxhetin e shtetit të vitit 2015”. E kemi miratuar në parim.

Fillojmë me nenin 1.

Neni 1. Ka ndonjë gjë në lidhje me këtë nen. Zoti Fino, keni ndonjë gjë?

Dakord.

Neni 2. Dakord.

Neni 3 “Buxheti vendor”. Dakord.

*(Diskutime pa mikrofon)*

Neni 4 “Buxheti i sigurimeve shoqërore”. Dakord.

Neni 5 “Buxheti i sigurimeve shëndetësore”. Dakord.

Neni 6 “Buxheti i fondit për kompensimin në vlerë të pronarëve”. Dakord.

Neni 7 “Përdorimi dhe investimi i fondit rezervë në sigurimet shoqërore shëndetësore, bëhet sipas dispozitave”. Dakord.

Neni 8 “Të ardhurat e buxhetit të shtetit sipas grupeve kryesore”. Dakord.

Neni 9. Dakord

Neni 10. Dakord.

Neni 11. Dakord.

Neni 12 “Paga e Presidentit të Republikës”. Dakord.

Neni 13. Dakord.

Neni 14 “Buxheti i pushtetit gjyqësor”. Dakord.

Neni 15 “Transfertat e pakushtëzuara”. Po, zoti Fino.

**Bashkim Fino** – Këtu kemi diskutuar dhe kemi bërë një set ndryshimesh, të cilat më lejoni t’i them ose t’i draftoj për t’ia paraqitur Komisionit të Ekonomisë. Në paragrafin e katërt të nenit 15, ku thuhet “rregullat, procedurat që lidhen me periudhën transitore të mbylljes së mandatit të zgjedhurve vendorë 2011 dhe funksionimin e njësive të reja të dala nga zgjedhjet e vitit 2015, jepen në Aneksin 6”. Këtij paragrafi i shtohen paragrafët e mëposhtëm, të cilët janë: “Për implementimin e reformës administrativo-territoriale, të miratuar në ligjin 115/2014, datë 31.7.2014, pranë Ministrit për Çështjet Vendore krijohet Agjencia e Implementimit të Reformës Territoriale. Kjo agjenci do të përbëhet nga 12 inspektorë. Këshilli i Ministrave brenda dy javësh pas hyrjes në fuqi të ligjit të buxhetit të vitit 2015 miraton aktet e nevojshme për mënyrën dhe

krijimin e kësaj agjencie. Transferta e pakushtëzuar për bashkitë dhe komunat do të ndahet në muaj dhe 3-mujorë, për rastet e nevojshme për zbatimin e reformës reale, Këshilli i Ministrave nxjerr aktet e nevojshme”.

Pra, çfarë dua të them me këtë ndryshim? Po ta lexojmë këtë paragraf thotë: “rregullat, procedurat që lidhen me periudhën transitorë të pushtetit vendor gjatë vitit 2015 do të bëhen sipas Aneksit 6”. Unë kam bërë një sërë diskutimesh për Aneksin 6, që ju thashë që është një rregullore dhe i propozoj Komisionit të Ekonomisë, pasi e kam diskutuar edhe me përfaqësuesit e Ministrisë së Financave, që propozoj pikërisht këtë krijim të agjencisë të 12 inspektorëve që ju thashë, që do të jenë për implementimin e ligjit të ndarjes territoriale-administrative, pra do të ketë një fond ku ne këtu nuk e kemi parashikuar fondin, por që do ta gjejë fondin Ministria e Financave jo më shumë se 6 milionë lekë për këta 12 persona që do të merren me implementim e ligjit për ndarjen territoriale. Ju e dini që ndarja territoriale do të ketë shumë probleme dhe punë kur të hyjë në fuqi, sepse kemi të bëjmë me kalim pronash, kemi të bëjmë me kontrata të ndryshme të ish-komunave, të cilat do të bashkohen në një bashki të madhe dhe gjatë ditëve të punës mund të na krijojnë shumë probleme, ku kjo Agjenci me aktet nënligjore, duke i formuluar dhe duke ia dhënë qeverisë, mund të marrë vendime qeverie që të ecë përpara për zhvillimin e saj. Ndërkohë që Aneksi 6 ishte me ligj dhe për çdo veprimtari që do të kishim gjatë aktivitetit të vitit 2015, duhet të vinim prapë në ligj për të bërë ndryshimet ligjore kur të kishim probleme midis ish-komunave dhe bashkive. Pra, ky është thelbi i këtij ndryshimi të këtij paragrafi me këtë që unë thashë dhe këtë unë do t’ia depozitoj Komisionit të Ekonomisë. Nuk e di nëse Ministria e Financave është dakord apo jo, ky është thelbi për paragrafin e katërt.

Vazhdojmë më poshtë, ku kemi bashkitë që kanë deri në 20 mijë banorë, të cilat përdorin 20% të transfertës së pakushtëzuar për koston e personelit. Nga 20% kjo bëhet 40%.

Paragrafi tjetër, bashkitë sepse i kanë të gjithë paragrafët me radhë, pra nga 20% bëhet 40%, tjetra nga 15% bëhet 30%. E keni ligjin përpara që të mos e lexoj të gjithë paragrafin. Nga 20 deri në 50 mijë banorë përdorin deri në 15% të transfertës së pakushtëzuar me koston e procedimit administrimit, nga 15% bëhet në 30%.

Paragrafi tjetër, komunat që kanë deri në 3 mijë banorë përdorin deri në 40% të transfertës së pakushtëzuar me koston e procedimit administrativ deri në 40% bëhet 80%.

Komunat që kanë 3 mijë deri në 10 mijë banorë përdorin deri në 35% të procedimit administrativ dhe kjo nga 35% bëhet 70%.

Komunat nga 10 mijë deri në 15 mijë banorë përdorin 30% të transfertës, kjo nga 30% bëhet 60%.

Për komunat që kanë mbi 15 mijë banorë deri në 25% të transfertës së pakushtëzuar do të bëhet 50%. Në vazhdim të paragrafit të tretë, nga fundi shtohet që: “shpenzimet për pagat, sigurimet shoqërore për ndërmarrjet e rrugëve të këshillave dhe qarqeve duhet të jetë 30% e buxhetit të këtyre ndërmarrjeve”. Ky 30% në fakt është pak, por duhet ta bëjmë 40%.

Çfarë kam bërë me këto, zoti kryetar? Kam detajuar, kam rritur mundësinë e grantit të pakushtëzuar për komunat që në periudhën 5-6 mujore që do të jetë viti tjetër, këto komuna që do të suprimohen në përgjithësi, të kenë shpenzimet e nevojshme: paga, shpenzime, shërbime për komunitetin, por ne nuk pretendojmë që këto të kenë ndonjë aktivitet tjetër, pra t’i themi gjërat siç janë. Përse? I kemi ruajtur të gjitha fondet, pra nuk e kemi prekur fondin e pushtetit lokal, të gjitha fondet që kemi edhe për sa u përket pjesës së këtyre komunave i kemi ruajtur për t’ia kaluar 61 bashkive në rang Shqipërie, mbas 6-mujorit të dytë. Le të themi që në qoftë se ne bëjmë disa kufizime, këto kufizime i bëjmë në sensin pozitiv, por aspak që të futemi në qesen e pushtetit vendor, të marrim fonde nga pushteti vendor për t’ia shpënë një sektori tjetër, për shembull, transportit, shëndetësisë apo arsimit. Përkundrazi, ne themi që këto komuna do të kenë shpenzimet e nevojshme për tatimet dhe pagat për ta kryer aktivitetin në këta 6 muajt e fundit që kanë. Ndërsa të gjithë grantin dhe të gjitha investimet, e gjithë pjesa tjetër, do t’u kalojë të 61 bashkive, ku do të jenë pjesë përbërëse edhe këto ish- komuna, që janë këtu. Prandaj bëj këto ndryshime përkatëse.

Kemi bërë ndryshime për këshillat e qarqeve që edhe qarqet do t’i ulin si numër punonjësish e me radhë, ndaj kemi bërë edhe këtë paragrafin e fundit, që sapo lexova edhe për ndërmarrjet e rrugëve rurale, të cilat duhet të kemi 40% të buxhetit vjetor të këtyre ndërmarrjeve nga do të kalojnë këto shpenzime.

Këto janë ndryshimet që ne bëjmë në nenin 15 dhe që do t’i paraqesim në Komisionin e Ekonomisë.

**Fatmir Xhafaj** – Kolegë, jeni dakord me propozimin e zoti Fino? Dakord.

**Bashkim Fino** – Përpara se të vijmë te neni 16 kam dy propozime aneksesh, të cilat janë në funksion të këtij neni, sepse nenet e tjera nuk kanë lidhje me anekset dhe ne duhet t'i bëjmë propozimet. Domethënë me atë që sapo miratuar, aneksi 6 i projektligjit të buxhetit të viti 2015 të hiqet. I gjithë aneksi 6 bie.

Pika 8 e aneksit numër 1, po ta shikojmë bëhet: “Ky fond krijohet duke u zbritur 22% nga granti i përgjithshëm i qeverisjes vendore që është 1,2 miliardë lekë. Nga ky fond do t'u shpërndahet qeverisjeve vendore përkatëse sipas ndarjes administrativo- territoriale, që do të zgjidhen në vitin 2015. Shpërndarja do të bëhet nga Ministria e Financave. Kriteri i shpërndarjes do të jetë burimi i krijimit të këtij fondi nga njësitet e qeverisjes vendore dhe suprimohet”.

Pra, hiqet e gjithë kjo pjesa këtu që e lexova, pika 8 e aneksit 1 do të bëhet: “Ky fond do të akordohet si vijon: shuma prej 726 e 300 mijë lekësh do t'u shpërndahet 61 bashkive, që do të jenë pas ndarjes së re administrative të buxhetit të vitit 2015. Për këto bashki do të rriten 5% në krahasim me vitin 2014.

Pra, grantet e pakushtëzuara për 61 bashkitë e reja sapo të fillojnë do ta jenë 105%. Pra, do të kenë 5% më shumë nga sa e kanë pasur në vitin 2014.

Shuma 2 milionë 633 mijë lekë do të jetë fond tranzitor në zbatim të reformës territoriale. Ky fond do të përdoret për shpenzime dhe investime të tjera. Fondi do t'u akordohet njësive të qeverisjes vendore me vendim të Këshillit të Ministrave. Pra, lëmë një fond në momentin, që bëjmë kalimin e pushtetit, i cili mund të mos ketë mundësinë dot pushteti vendor të krijojë dhe të bëjë të gjitha alokime fondesh, tendera etj., dhe për efekte që ne të mos e lëmë komitetin pa investime, i themi Ministrisë së Financave dhe Kryeministrisë që përdoren në momentin që ne të bëjmë disa investime në njësitet e pushtetit vendor, derisa të krijohen njësitet e reja. Të mos harrojmë njësitet e reja që krijohen nuk u preket fondi i investimeve. Pra, 61 bashkitë do ta kenë më vete fondin e investimeve.

Ky është një fond shtesë nga diferenca që thashë pak më lartë. Pra, të dyja këto shifra që përmenda tani dhe që duhet bërë kështu siç them unë, janë shifra që nuk kanë lidhje me transfertën e pakushtëzuar dhe me investimet e 61 bashkive të reja që krijohen pas muajit korrik ose kur ta miratojë Presidenti datën e zgjedhjeve. Fjalët e pikës së parë të aneksit 2 nuk duhet të kalojnë....

**Fatmir Xhafaj** – Jo, mbyllim tërësisht nenin 15 që ta votojmë pastaj.

**Bashkim Fino** – ...duhet të kalojë 50% dhe nuk duhet të kalojë 70% dhe tabela shoqëruese e ligjit nr.3 të ligjit të buxheti të vitit 2015. “Tranferta e pakushtëzuar për bashkitë dhe komunat” ndryshon duke zvogëluar tabelën. Pra, kjo që thashë tani është meqenëse ne votuam këto shifra absolutisht tabela e transfertës së pakushtëzuar do të ndryshohet. Do të bëhet një tabelë e re në funksion të atyre që thashë.

Këto janë ndryshimet që unë kam diskutuar si këtu, edhe në parlament për projektbuxhetin për sa i përket nenit 15 dhe anekseve, që kanë të bëjnë me pushtetin vendor në tërësi.

**Fatmir Xhafaj** – Jemi dakord me propozimet e zotit Fino që t’ia kalojmë Komisionit të Ekonomisë? Ka vërejtje apo sugjerime? Nuk ka. Dakord.

Kush është dakord me nenin 16? Dakord.

Kush është dakord me nenin 17? Dakord.

Kush është dakord me nenin 18? Dakord.

Kush është dakord me nenin 19? Dakord.

Kush është dakord me nenin 20? Dakord.

Përpara se ta votojmë në tërësi, keni parasysh që kemi tabelën. Nuk kemi nevojë ta lexojmë, sepse e kanë të gjithë. Ne e kemi kaluar atë, përfshirë edhe këto të Presidencës.

**Bashkim Fino** - Për projektbuxhetin ne kemi bërë një relacion, zoti kryetar. Ato që kemi miratuar në seancat dëgjimore, që janë të gjitha institucionet e pavarura, që kanë ardhur dhe kanë bërë kërkesa (ne kemi marrë përsipër disa kërkesa që duam t’i zgjidhim), i keni të shkruara në relacion, duke futur edhe Presidencën që është e para. Këtë relacion ne do t’ia nisim Komisionit të Ekonomisë të gjitha kërkesat, që kanë bërë institucionet e pavarura, qoftë për numër punonjësish, qoftë për shpenzime operative apo dhe investime.

Janë të shënuara të gjitha këtu. Në qoftë se një nga kolegët ka vërejtje për relacionin si është bërë, ta korrigjojmë që ta dërgojmë me firmën tuaj te Komisioni i Ekonomisë që të merret në konsideratë.

**Fatmir Xhafaj** – Dakord.

Jemi dakord me të gjitha këto? Dakord.

E mbyllim.

Faleminderit!

Kush ka ndonjë gjë për saktësi te tabela, le të qëndrojë më mbrapa me relatorin dhe me mua që t'i shikojmë përpara se të mbyllim raportin për t'ia dërguar Komisionit të Ekonomisë. T'i saktësojmë ato përfundimisht, sepse edhe mund të ketë ndonjë pasaktësi në emërtimet në shifra që mund të na ketë shpëtuar.

Ministria e Financave besoj se është dakord me të gjithë procedurën e komisionit?

**Geraldina Prodani** – Plotësisht dakord.

**Fatmir Xhafaj** – Faleminderit!



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**

**KUVENDI**

***Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut***

**Dokument parlamentar**

**PROCESVERBAL**

Datë 18.11.2014, ora 09:00

**Drejton mbledhjen:**

**Fatmir Xhafaj – kryetar i Komisionit**

**Rendi i ditës:**

Projektvendim për miratimin e strukturës dhe organikës së Komisionerit të Mbikëqyrjes së Shërbimit Civil.

**Marrin pjesë:**

Fatmir Xhafaj, Blendi Klosi, Armando Subashi, Bashkim Fino, Ulsi Manja, Xhemal Qefalia, Petrit Vasili, Dashamir Peza, Spartak Braho, Armando Prenga, Vasilika Hysi, Pandeli Majko, Pirro Lutaj, Nard Ndoka dhe Tahir Muhedini.

**Mungojnë:**

Oerd Bylykbashi Gent Strazimiri, Fatmir Mediu, Edi Paloka, Mhill Fufi, Eduard Halimi, Kastriot Islami, Keltis Kruja, Mark Frroku, Vexhi Muçmataj, Gjovalin Bzheta, Arben Ristani, Silva Caka dhe Tom Doshi.

**Të ftuar:**

Pranvera Strakosha - Komisionere e Mbikëqyrjes së Shërbimit Civil.

**Fatmir Xhafaj** - Vazhdojmë me shqyrtimin e strukturës dhe organikës së Komisionerit të Shërbimit Civil .

Zonja Strakosha, urdhëroni!

**Pranvera Strakosha** - Faleminderit, zoti kryetar!

Ashtu siç dihet, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil është krijuar si një institucion i posaçëm që mbikëqyr të gjithë administrimin e shërbimit civil, duke filluar nga mbikëqyrja periodike dhe inspekton dhe bën hetim administrativ nëse çmon se ka vend sipas Kodit të Procedurave Administrative.

Po të shikosh, ligjvënësi ka dhënë një rëndësi shumë të veçantë dhe shumë kompetenca komisionerit në krahasim me ato të komisionit të shërbimit civil, duke krahasuar kompetencat në dy ligjet: atë të vitit 1999, komisioni i shërbimit civil mbikëqyrte dhe shqyrtonte ankesat, ndërsa komisioneri mbikëqyr, merr dëshmi, bën hetim administrativ dhe ajo që është më e rëndësishme ndëshkon punonjësën e administratës shtetërore, i cili ka arritur ose ka sjellë këtë gjendje paligjshmërie. Duke ushtruar kompetencat e komisionerit mendoj se nuk dublohen me punën e komisionerit, ose komisioneri nuk dublon punën e tyre për faktin se Gjykata Administrative shqyrtton aktet normative ose individuale dhe vendos nëse duhet lënë në fuqi ose duhet anuluar ky akt. Ndërsa komisioneri shqyrtton aktin, por në konceptin e procedurës së vendimmarrjes ndëshkon punonjësën e administratës shtetërore, i cili ka sjellë këtë anë të kundërligjshme, ose absolutisht të pavlefshme dhe kërkon nga institucionet ose revokimin nga institucioni që e ka nxjerrë ose anulimin, shfuqizimin nga eprori në varësi vertikale.

Struktura e mëparshme e Komisionit të Shërbimit Civil, meqenëse unë jam e detyruar ta krahasoj për shkak edhe të buxhetit, ka qenë e miratuar me 28 persona, nga të cilët 5 kanë qenë komisionarë. Është një strukturë e miratuar në vitin 2002, nga Kuvendi dhe pjesa tjetër ishte sekretariat teknik.

Normalisht Ministria e Financave e ka sjellë më 24 jo për faj të tyre, por nga sa u informova, stafi teknik që ishte atje, ka bërë një propozim dhe ka thënë që struktura jonë është me 24. Këtë informacion më thanë, duke pasur parasysh që kanë ikur komisionerët.

Tani vërtet kanë ikur komisionarët, por problemi është se komisionarët bënin një punë atje, sepse arsyetonin vendimet që është një moment shumë i rëndësishëm. Pra kryenin procesin e ankimit të një gjykate administrative dhe arsyetonin veprimet.

Struktura e komisionerit që është sjellë edhe për miratim unë e kam konceptuar në bazë të objektit të veprimtarisë dhe jo në bazë të subjekteve që hetohen ose që mbikëqyrren, që do të thotë është konceptuar një drejtori e përgjithshme, e cila do të jetë më e rëndësishme e mbikëqyrjes dhe e inspektimit që do të ketë në varësi vetëm dy drejtori, që është ajo e mbikëqyrjes, që do të jetë një mbikëqyrje e vazhdueshme dhe inspektimi dhe hetimi administrativ, i cili kërkon një procedurë paksa më të gjatë, pasi në qoftë se gjatë inspektimit do të konstatohen që ka shkelje do të fillojë detyrimisht hetimi administrativ që të rezultosh me një vendimarrje të komisionerit.

Në strukturën e mëparshme ishin vetëm dy drejtori, vetëm ajo e mbikëqyrjes me 6 inspektorë dhe një drejtori e shërbimeve operationale dhe shërbimeve mbështetëse me disa punonjës, me 3 shefa sektori, pra në radhë vertikale.

Kam menduar që duhet hequr sekretari i Përgjithshëm si një hallkë që për mua nuk përmbushte ato kërkesa që do të kisha ndaj strukturës, duke vendosur një drejtor të Përgjithshëm, pasi drejtorit e përgjithshme mund t'i delegohen edhe kompetencat të cilat janë të mirëfilltë administrative, pra me një autorizim, por ajo që është më kryesorja drejtori i Përgjithshëm mund të ndërmarrë edhe vetë në krye të grupeve edhe inspektime, që është mjaft i rëndësishëm. Pra, është hequr si hallkë si një rrogë e lartë për t'u zëvendësuar me një punonjës, i cili vërtet do të jetë në objektin e veprimtarisë së komisionerit.

Është e detyrueshme të krijohet drejtoria juridike e marrëdhënieve me jashtë pasi nuk ekzistonte një e tillë për faktin se në qoftë se më parë Komisioni i Shërbimit Civil ishte një institucion si një Gjykatë Administrative për ankesat e nëpunësve civilë tani ajo do të jetë në gjykimet administrative, sepse aktet që do të nxjerrë komisioneri ka shumë të ngjarë për të mos paragjykuar, por do të shkojnë të shqyrtohen në gjykatat administrative. Është shumë e nevojshme të jetë prezente dhe detyrimisht kërkon edhe një staf të caktuar, pasi shtrirja e gjykatave administrative është në të gjithë vendin.

Është edhe drejtoria juridike dhe ajo e marrëdhënieve me jashtë. Minimumi është 4 specialistë, dhe drejtori. Nuk ka shef sektori. Janë hequr në strukturën e mëparshme shefat e sektorit si struktura, do të thosha, të ndërmjetme, të panevojshme, për të ulur të gjithë nivelin në nivel specialistësh, në mënyrë që të jenë sa më funksionalë, sa më operativë, që të kenë mundësi të dalin sa më shumë në terren.

Është edhe drejtoria e shërbimeve mbështetëse, e cila ka vetëm minimumin e minimumit të punonjësve, burimet njerëzore një IT, marrëdhënie me publikun, financë, buxhet. Ishin dy më përpara tani është lënë vetëm një, pasi është e tepruar të ishin dy dhe në numrin 32 të propozuar, 3 janë punonjës që trajtohen me kodin e punës, sepse është punonjësi i mirëmbajtjes apo shoferi apo punonjësja e pastrimit.

Kjo ishte shkurtimisht ajo që unë kam planifikuar. Pra, drejtoria e inspektimit, si të thuash drejtoria e mbikëqyrjes, është lënë me 6 inspektorë, siç ka qenë në kohën e KSHC-s dhe kërkohet shtesa prej 8 personash që është drejtoria e inspektimit dhe hetimit administrativ, e cila është përcaktuar me 6 inspektorë si punonjës të posaçëm.

Faleminderit!

**Fatmir Xhafaj** – Faleminderit!

Relatori, zoti Peza, urdhëroni!

**Dashamir Peza** – Të nderuar anëtarë, Komisioni i Ligjeve bazuar në Rregulloren e Kuvendit dhe në kalendarin e punimeve të tij në cilësinë e komisionit përgjegjës do të shqyrtojë sot propozimin e paraqitur nga komisionerja për mbikëqyrjen e shërbimit civil për miratimin e strukturës organike dhe vendeve të punës të sekretariatit të komisionerit.

Komisioni i Ekonomisë në kalendarin e punimeve të tij më ka caktuar relator për shqyrtimin e kësaj kërkesë. Në cilësinë e relatorit u njoha me propozimin e mësipërm të paraqitur nga komisionerja. Gjithashtu, u njoha edhe me dokumentacionin shkencor që Kuvendi i ka drejtuar DAP-it dhe Ministrisë së Financave për strukturën organike dhe vendet e punës së sekretariatit.

Do të më lejoni paraprakisht të nënvizoj se shërbimi civil është një faktor strategjik në zhvillimin ekonomik dhe social të çdo vendi. Ai ndikon madje bëhet përcaktues për çdo plan zhvillimor dhe për këtë arsye përmirësimi i këtij sistemi dhe kontrolli nga ana e institucioneve, por edhe shoqërisë në përgjithësi është shumë i madh në funksion të mirëfunksionimit, si dhe në kërkimin e rrugëve të reja për përsosjen e vazhdueshme të tij

Ky nuk është një fenomen shqiptar. Kjo është një sfidë sot edhe për vendet e zhvilluara, por në kontekstin shqiptar kjo merr një rëndësi edhe më të madhe nëse marrim parasysh atë që ka ndodhur me administratën publike gjatë gjithë këtyre viteve.

Për këtë arsye gjykoj se parlamenti shqiptar ka ndërmarrë hapa shumë të rëndësishëm sidomos vitet e fundit në drejtim të përmirësimit të funksionimit të shërbimit civil. Nëpërmjet ndryshimeve legislative, si dhe krijimit të instrumenteve të reja institucionale, të cilat kanë si qëllim shëndoshjen e shërbimit civil mund të përmend këtu krijimin e Gjykatës Administrative apo ligjin për nëpunësin civil, i cili parashikon edhe krijimin e institucionit të komisionit për mbikëqyrjen e shërbimit civil si personi përgjegjës për mbikëqyrjen e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil.

Në pamje të parë mund të krijohet përshtypja se Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil pas krijimit të Gjykatës Administrative i është ngushtuar fusha e veprimit. Nëse lexohet me kujdes ligji, është e lehtë të kuptohet se vullneti i ligjvënësit e ka transformuar rrënjësisht misionin e komisionerit, duke i dhënë një rol dhe një dimension krejt të ri këtij institucioni. Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil në zbatim të nenit 12 të ligjit 152 /2014 u zgjodh nga Kuvendi. Menjëherë pas zgjedhjes, komisioneri ka si detyrim të ngrejë sekretariatit dhe të paraqesë në Kuvend për miratim strukturën organike dhe vendet e punës.

Për të mos u zgjatur, sepse materialin kolegët e kanë përpara, dua vetëm të vë theksin te një gjë mjaft e rëndësishme. Në pikëpamjen time çështja e shërbimit civil sot edhe në botën e zhvilluar, në të gjitha vendet moderne, është një problem shumë i rëndësishëm dhe çështja e shërbimit civil në përgjithësi ka një vlerë të jashtëzakonshme lidhur me eficiencën saqë teori të caktuara thonë se më e rëndësishme se thithja e investimeve është mirëfunksionimi i shërbimit civil, sepse nëpërmjet një administrate, e cila është funksionale dhe efiçente kursehen më shumë para se sa nga vetë investimet që mund të thithen me një ekonomi të caktuar. Në këtë pikëpamje ajo që ne kemi bërë 2 vjetët e fundit për përsosjen e shërbimit civil dhe njëkohësisht ajo që ne përpiqemi të bëjmë sot për t'i dhënë skelet institucionit të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil është një çështje e eficiencës ekonomike në përgjithësi dhe rritjes së standardit të shërbimit civil dhe administratës civile në vendin tonë. Për këtë arsye unë nuk do të zgjatem më tej, jam i bindur që është i nevojshëm. Nuk marr përsipër të bëj ekspertin për të hyrë në detaje, por mendoj se në përgjithësi kjo duhet mbështetur dhe është me interes.

Faleminderit!

**Fatmir Xhafaj** – Faleminderit, zoti Peza!

Dëgjuam komisioneren, e cila bëri paraqitjen e strukturës dhe organigramën e re të ekipit të komisionerit në përputhje me ligjin përkatës të shërbimit civil. Dëgjuam edhe relatorin, zotin Peza, i cili dha mbështetjen për këtë projektvendim.

Kush ka pyetje?

Zoti Fino, urdhëroni!

**Bashkim Fino** – Faleminderit, zoti kryetar!

Edhe unë duke mos dashur të bëj punën e ekspertit, dua të bëj një pyetje më shumë për departamentin sesa për komisioneren që kemi votuar ne, sepse në fund të fundit, komisionerja është e re, pavarësisht argumenteve shumë profesionale që dha, do t'i duhet kohë të merret me institucionin.

Pyetja ime për departamentin është: Në qoftë se ne kemi pasur një strukturë me 5 anëtarë të komisionit të shërbimit civil dhe kishim një strukturë deri në 28 vetë, sot që do të kemi vetëm një komisioner, duke pasur parasysh që kemi krijuar me vendim, me ligj gjykatat administrative, mos ndoshta nuk përkojnë këto dy struktura, ajo e kaluara, që kemi me 28 dhe kjo e sotmja që na del tani me 32? Sepse po të hysh në pyetje të tjera teknike, unë jam kategorikisht kundër krijimit të drejtorit të përgjithshëm, jam për sekretar të përgjithshëm në çdo institucion dhe ne duhet të kemi një standard për të gjitha institucionet.

Më vjen keq që departamenti ynë i monitorimit dhe departamenti në Këshillin e Ministrave nuk kanë bërë asnjë vërejtje, si duket nuk kanë pasur kohë dhe nuk e kanë parë se pse kur duan e shikojnë me lupë shumë të madhe bëjnë vërejtje dhe pengesa të mëdha dhe nuk jam dakord, pastaj edhe me drejtoritë ndihmëse që shtohen specialistë pa fund kur nuk kanë asnjë funksion.

Po të lexoni formularin e dytë keni drejtor, specialistë IT-je, jam plotësisht dakord, specialist për marrëdhëniet me publikun, që mjaft mirë mund ta bëjë kabinetin, një specialist për emërtim, pra, do të jetë kot atje, nuk e di fare se çfarë pune do të bëjë, ka specialistë për financën dhe buxhetin, që jam plotësisht dakord ka edhe specialistë për arkiv dhe protokoll. Pra, po ta marrim nga pikëpamja e ndarjes strukturore unë mund të bëj shumë pyetje. Por ajo që mua më shqetëson, zoti kryetar është: kishim komisionin me 5 këshilltarë, me 5 anëtarë, të cilët bënin edhe punën e gjykatës administrative, sot kemi një komisioner që do të na mbrojë nëpunësin

civil por që në fakt nuk do të bëjë punën e atyre 5 komisionerëve se atë do ta bëjë gjykata administrative: Cili është roli dhe ideja që ka dhënë DAP-i në këtë strukturë organizative?

**Fatmir Xhafaj** – Faleminderit!

Fillimisht do të dëgjojmë përfaqësuesen e departamentit në Ministrinë e Financave dhe në fund vetë komisioneren.

**Vilma Çausholli** – Në lidhje me numrin që është rritur duhet të mbani parasysh edhe logjikën tonë, pse kemi thënë dakord edhe për numrin që është shtuar në krahasim me Komisionin e Shërbimit Civil që ishte. Fusha e veprimit të legjislacionit të shërbimit civil ka ndryshuar shumë në krahasim me ligjin e mëparshëm.

Me ligjin e mëparshëm llogariteshin diku rreth 10 mijë nëpunës civilë, 7 mijë - 8 mijë, 10 mijë me gjithë pushtetin vendor. Ndërsa sot është pothuajse trefishuar numri, për shkak edhe të futjes në shërbim civil të institucioneve në varësi të Kryeministrit apo të ministrive të linjës apo të komunave për sa kohë që janë në momentin që flasim. Kështu që për sa kohë është rritur puna, është rritur numri i institucioneve patjetër rritet edhe numri. Për këtë arsye ne kemi thënë jemi shprehur dakord me numrin e rritur të komisionit.

**Fatmir Xhafaj** – Faleminderit!

*(Bashkim Fino flet pa mikrofon.)*

Me ndryshimin nga 5 komisionerë në 1 komisioner kompetencat janë lehtësuar apo janë shtuar, me ligjin e ri për shërbimin civil? Kjo ishte pak a shumë pyetja e kolegut Fino.

**Vilma Çausholli** - Sigurisht që kompetenca nuk është më e njëjta në krahasim me Komisionin e Shërbimit Civil. Komisioni i Shërbimit Civil kishte dy kompetenca vepronte dhe si *quasi* gjykatë fakti.

Komisionieri nuk e ka më këtë, por kjo në logjikën tonë, pra, heqja e kompetencës së gjyqimit të ankimeve të nëpunësve civilë që e kryenin komisionerët nuk e cenon pjesën tjetër atë që thamë ne në logjikë është rritur numri i atyre institucioneve që duhet të kontrollohen dhe për këtë arsye është rritur numri. Pra nuk bëhet një lidhje e drejtpërdrejtë në kuptimin e heqjes së kësaj kompetence nga komisioneri.

**Fatmir Xhafaj** – Ka pasur përpara Komisioni i Shërbimit Civil funksionin e inspektimit dhe të hetimit administrativ?

**Vilma Çausholli** – Po, e ka pasur. Ka pasur funksionin e mbikëqyrjes të kontrollit. Nuk bënte hetim administrativ, por vetëm kontrollonte, linte rekomandim dhe nuk kishte një fuqi më tutje për rekomandimin që linte. Ndërkohë me komisionerin bënte hetim administrativ jo vetëm rekomandim, por detyron të rregullohet paligjshmëria deri në vendosjen e gjobave nëse ajo nuk rregullohet.

**Fatmir Xhafaj** – Faleminderit!

Zonja Dhëmbi, urdhëroni!

**Mimoza Dhëmbi** – Në fakt ne patëm një kohë shumë të shkurtër për t’u konsultuar me këtë strukturë. Specialistët tanë u konsultuan edhe me DAPI-n paraprakisht meqenëse ata ishin marrë edhe kohë përpara me këtë strukturë. Përgjithësisht jemi dakord. Edhe ne kemi merakun e sekretarit të Përgjithshëm. E kishim si një pikëpyetje në qoftë se do të ruajmë një standard.

Megjithatë DAPI duke qenë se është përgjegjës për përmbajtjen e strukturës është shprehur dakord kështu që edhe ne e mbështesim komentin e tyre. Ndoshta në stafin mbështetës mund të shikohej, mbështes zotin Fino, mund të shikohet ndonjë pozicion nëse është i tepërt, por përgjithësisht duke njohur zgjerimin e fushës së veprimi të ligjit civil tani pranojmë një rritje të numrit të punonjësve në këtë institucion.

**Fatmir Xhafaj** – Faleminderit!

**Dashamir Peza** – Zoti kryetar, unë e mirëkuptoj shqetësimin e zotit Fino.

Zoti Fino është një nga deputetët me eksperiencë në këtë komision, është një njeri që ka eksperiencë administrative të shkëlqyer dhe natyrisht është gjirokastrit dhe nikoqir dhe kërkon që çdo lek i shtetit të miradministrohet.

Ajo ku doja të vija theksin është që nuk duhet të na ngatërrojë institucioni që ka qenë më parë me mënyrën si ne vetë e kemi dizenuar këtë institucion dhe formën që i kemi dhënë këtij institucioni. Nuk ka lidhje.

Dua ta përsëris edhe një herë: në qoftë se komisioneri do ta kryejë mirë detyrën e tij, dhe unë kam besim që komisioneri do ta kryejë mirë, sepse edhe kam firmosur, kam qenë një nga firmëtarët e kandidaturës së komisionerit, mendoj që nëse komisioneri do ta kryejë mirë këtë detyrë ka një eficiencë ekonomike të jashtëzakonshme për ekonominë e vendit, sepse duke e ndjekur procesin në të gjithë tërësinë e veprimtarisë së nëpunësit civilë unë mendoj dhe me hapësirën që i ka dhënë ligji për të ndëshkuar ata punonjës të administratës, të cilët nuk veprojnë

në përputhje me shërbimin civil, unë mendoj se ka një eficiencë ekonomike dhe ka një kursim në ekonominë e vendit. Në këtë pikëpamje do të thosha se nuk është vetëm çështja e rritjes së numrit të nëpunësve civilë që bëhen objekt i veprimtarisë së këtij institucioni, por do të thosha se për mënyrën e re të të shikuarit nuk duhet të bëhet pengesë koncepti që kemi pasur për institucionin si ka qenë. Duhet të kemi parasysh institucionin me objektivat që ndërtohen dhe në këtë pikëpamje unë mendoj se duhet të ketë mbështetje.

Për sa i përket emërimit, bie dakord me zotën Fino që ndoshta është e nevojshme për të bërë disa saktësime dhe disa ndryshime emërimesh në pozicione të caktuara, por unë mendoj se në përgjithësi projekti duhet mbështetur.

**Fatmir Xhafaj** - Faleminderit!

Ka pyetje të tjera, para se të fillojmë diskutimin dhe komentet që mund të jenë?

Po, zoti Manja.

**Ulsi Manja** – Unë duke qenë dakord me strukturën, desha të di pse është emërtuar drejtori i Përgjithshëm i Inspektimit dhe Mbikëqyrjes dhe të mos jetë funksioni i sekretarit të Përgjithshëm? Këtë dua të di si koncept, si nocion. Pse nuk është pranuar që të ketë sekretar të përgjithshëm, por është futur koncepti i drejtorit të përgjithshëm?

**Fatmir Xhafaj** – Po, zonja Strakosha.

**Pranvera Strakosha** – Duke parë paralel strukturat e komisionerëve të tjerë, që janë zgjedhur po nga Kuvendi, nuk ekziston funksioni i sekretarit të përgjithshëm. Në bazë të ligjit dhe akteve nënligjore funksioni i sekretarit të përgjithshëm është në ato institucione me një numër shumë të madh punonjësish dhe me struktura shumë të mëdha që do të thotë drejtori të përgjithshme, drejtori të ndërruarura sektore dhe është punonjësi administrativ më i lartë. Ai është vetëm brenda institucionit dhe merret vetëm me punën administrative. Në qoftë se ne si shtet kemi luksin që të kemi një sekretar të përgjithshëm, i cili nuk do të bëjë asnjë gjë, për sa i përket mbështetjes së komisionerit në funksionet e tij të hetimit administrativ, hajde ta vendosim. Pra, është një person që do të marrë një rrogë shumë të lartë. Mbas komisionerit është rroga më e lartë dhe nuk do të bëjë asnjë punë. Pra, do të firmosë rrogat, do të firmosë buxhetin, do të shikojë hyrje-daljet e punonjësve, sepse ky është funksioni i sekretarit të përgjithshëm. Ndërsa komisionerët e tjerë dhe në institucione me strukturë shumë të vogël, unë u konsultova dhe me DAP-in, pashë pak strukturat paralele, nuk e kanë, sepse nuk kanë luksin që të kenë një strukturë

të fryrë. Drejtori i përgjithshëm është ai që do të unifikojë praktikën. Kjo është shumë e rëndësishme.

Domethënë ideja pse u ndërtua në dy drejtori dhe me një drejtori të përgjithshme. Është shumë interesante, sepse të paktën unë jam munduar që t'i hyj thelbit asaj që ka dashur të vendosë ligjvënësi. Komisioneri duhet të jetë një person mbi palët, i cili mbikëqyr në vazhdimësi procesin, por në momentin e një përfundimi të një procesi, kur ka ardhur një rast paligjshmërie, ose një akt i paligjshëm, ai automatikisht duhet të fillojë inspektimin, hetimin, merr dokumente, merr dëshmi nga punonjësit, inspekton dosjen, pra fillon një procedurë të gjatë. Në qoftë se ne do t'i kishim në një drejtori të dyja, atëherë do të kishte një farë konflikti interesi dhe aty edhe njerëzit do të fillonin të mbronin dhe njëri-tjetrin brenda së njëjtës drejtori. Sepse në qoftë se unë mbikëqyr nga fillimi në fund dhe në fund rezulton se është e kundërligjshme, atëherë edhe punonjësi që ka mbikëqyrur është në pozita që ka shkelur ligjin. Kjo është dhe një farë si të thuash një balancë dhe një kontroll edhe midis tyre, por është drejtori i përgjithshëm, i cili unifikon praktikën, pra qëndrimin që duhet mbajtur, sepse për raste të ngjashme duhet që komisioneri të mbajë të njëjtin qëndrim. Kjo është ideja dhe koncepti për të kursyer më shumë. Domethënë nuk mund të vendosja një sekretar të përgjithshëm që të rrinte kot. Kjo ishte ideja që kam.

Për sa u përket funksioneve, nuk po i citoj, sepse komisioni në vitin 1999 ka pasur, mbikëqyr dhe shqyrton ankesat”, vetëm një paragraf, ndërsa komisioneri ka dy dispozita dhe i ka shumë të detajuara, që ti je i detyruar t'i përgjigjesh procedurës gjatë punës. Nuk e di nëse jam e qartë.

Specialisti që është pa emër, ka shumë të drejtë, zoti Fino, ka shpëtuar, është i burimeve njerëzore. Ajo mund të bashkohet në marrëdhënie me publikun. Nuk prish punë. Domethënë shërbimet mbështetëse mund të bashkohen, nuk ka asnjë lloj problemi, ndërsa inspektorët janë të domosdoshëm. Kjo është ideja ime.

**Fatmir Xhafaj** – Po, zoti Fino, meqë e kishte radhën.

**Bashkim Fino** – Zoti kryetar,

Diskutimi dhe komenti im për këtë projekt që vjen këtu është se, së pari, duhet të kuptojmë që për komisionerin në fjalë edhe unë kam firmosur, kam qenë iniciator dhe nuk kam asgjë me personin në fjalë, por me strukturën. E kam me letrat që na vijnë këtu. Të mos e marrë

përsipër komisionerja ta mbrojë me kaq zjarr, me kaq fanatizëm, ajo do të bëjë punën e komisionerit, është zgjedhur nga ne, do të monitorohet nga ne. Natyrisht do një staf, por në fund të fundit unë debatin profesional e kam me Departamentin e Administratës Publike në Këshillin e Ministrave, që është me dy dhe me tre standarde. E kam me Drejtorinë e Monitorimit këtu në Kuvendin tonë që dhe ajo është me dy dhe me tre standarde dhe nuk na furnizon ne me materiale se si të jemi ne të përgatitur për të diskutuar, se si duhet të zgjidhim çështjen e strukturës. Zoti kryetar, sapo dolëm nga një diskutim shumë i gjatë, i lodhshëm, i mundimshëm, i buxhetit të 2015-s.

Zoti kryetar, po ju drejtohem përsëri ju dhe Vasilikës. Sapo dolëm nga një diskutim dhe thamë se të gjitha institucionet e pavarura që erdhën këtu në Komisionin e Ligjeve kërkuar me të drejtë fonde, kërkuar me të drejtë numër punonjësish. Asnjë institucion i pavarur nuk erdhi të thoshte këtu që zotërinjtë e komisionit të ligjeve janë 30 ose 50 punonjës dhe duhet të ulet numri i tyre. Se me efektivitetin e punës që do të bëhet duhen ulur 5 veta ose 10 veta. Të gjitha institucionet, zoti kryetar, erdhën dhe kërkuar shtesë numër punonjësish. Me të drejtë unë si relator dhe ju që më mbështetët, dhe jam shumë i bindur që mund të mos më mbështesni, tani, por shpresoj të më besoni në 2015-n, fat që ne do miratojmë buxhetin dhe shumë shpejt si Komision Ligjesh, duhet t'i rifutemi një analize të hollësishme edhe për departamentin, edhe për Drejtorinë e Monitorimeve, për të gjitha institucionet e pavarura për të parë strukturat ne si komision, se varen nga ne, emërohen nga ne, kontrollohen nga ne. Dhe meqë kontrollohen nga ne duhet t'u miratojmë dhe strukturën në mënyrë korrekte, rigorozë për të bërë punën me efektivitet.

Sapo e dhamë këtë njoftim, detyrë, zoti kryetar, e keni thënë ju në konkluzionet tuaja, ja ku vjen rasti i parë për të kaluar një strukturë të cilën me pa të drejtë kur erdhi për të kaluar buxheti i 2015-s që futur poshtë tavolinës edhe struktura që nuk duhej të bëhej ashtu. Bëre mirë më thanë, të kalojë struktura pastaj buxheti. Sot na vjen me shtim nga komisionerët apo nga Shërbimi Civil që ishte në datën 28, sot na vjen një komisioner që do të ketë vetëm një njeri me gjithë stafin e saj, me 32 vetë. Pikërisht për këtë arsye nuk po hyj në anën teknike, se po të hyj në anën teknike, për shkak të eksperiencës që kam, mund ta bëj copë këtë draft. Se po të hyj në anë teknike, zoti kryetar, jo për shkak të gjirokastritit kursimtar, por nuk e kuptoj dot se si mund të ketë shef kabineti pa pasur asnjë njeri në varësi. Nuk e kuptoj departamentin si e miraton. Shef

kabineti ka kur ka 3-4 këshilltarë, një drejtues, një ministër dhe ka një shef kabineti që bën koordinimin e punës së tij. Çfarë koordinimi do bëjë shefi i kabinetit të komisionerit? Do bëjë koordinimin e komisionerit dhe sekretares së tij? Këtë do të bëjë? Çfarë pune ka një drejtor i përgjithshëm dhe 3 drejtor të tjera? Çfarë do të bëjë drejtori i përgjithshëm? Jo, more zotërinj. Mund të kishte fare mirë, se komisioner është një, atje ajo është e madhja e punës dhe të ketë 3-4 drejtorë në sektorë të ndryshëm dhe të vazhdojnë të punojë.

Prandaj, zoti kryetar, nuk po hyj në anën teknike, se po të hyj në anë teknike do të bëj shumë vërejtje. Por jam i zhgënjyer që sapo dolëm nga diskutimi ne thamë që do të bëjmë këtë gjë, dhe menjëherë brenda një jave na vjen një strukturë dhe ne bëjmë sikur nuk kemi thënë asgjë para një jave. Prandaj jam kategorisht kundër kësaj strukture që është paraqitur. Jo për numrin dhe jo për njerëzit, ose strukturat, sepse struktura duhet miratuar, por mënyra se si është formatuar dhe që është dhënë ok-i nga Departamenti i Administratës Publike unë jam kundër.

Faleminderit!

**Fatmir Xhafaj** - Faleminderit!

Para se ta marrë fjalën zoti Braho dua të bëj një sqarim. Në rastin e komisionerit të Shërbimit Civil ne jemi të detyruar ta miratojmë strukturën, se është një funksion i ri. Ndryshe nga agjencitë e tjera të pavarura, të cilat janë në proces, dhe ne do t'i qëndrojmë asaj çfarë kemi thënë gjatë diskutimit të buxhetit që shumë shpejt para raportimit të tyre ose gjatë momentit të raportimit të tyre do të bëjmë një analizë edhe të strukturave edhe organigramave të tyre. Por sot jemi të detyruar ta bëjmë këtë për shkak se nëse ne nuk miratojmë strukturën dhe organigramën, komisioneri nuk mund të fillojë normalisht nga detyra. Ky është problemi. Janë çështje të tjera pastaj sugjerimet, vërejtjet, komentet që janë hajde t'i diskutojmë. Por jemi të detyruar ta bëjmë shqyrtimin dhe miratimin e këtij vendimi për t'ia kaluar pastaj për miratim seancës. Por thashë ky është një përjashtim për të cilin ne jemi të diktuar ta bëjmë.

Po, zoti Braho.

**Spartak Braho** - Faleminderit!

Që të mos bëjmë shumë zhurmë, shumë zhurmë për asgjë, ajo vajza ka ardhur këtu për mbështetje, të fillojë punën dhe në 2015- 2016, siç tha Fino, ne t'i bëjmë bilancin. Prandaj unë jam dakord me tërë strukturën. Sa kohë që edhe DAP-i edhe Ministria e Financave e kanë mbështetur, nuk jam dakord për sekretaren e përgjithshme. Detyrat dhe funksionet e sekretarit të

përgjithshëm janë të përcaktuara me ligj organik, janë të përcaktuara me ligjin “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave” të ministrive, prandaj nuk ka vend që ne të shpikim një funksion këtu për ta quajtur sekretar të përgjithshëm sa kohë nuk ka funksione të tjera të parashikuara në ligje të tjera. Jam dakord, mos ta e zgjasim më se kemi ndenjur deri në orën 1 të natës mbrëmë.

**Fatmir Xhafaj** – Dakord. Ka komente të tjera? Biem dakord ta miratojmë dhe të ulet departamenti bashkë me relatorin? Do të jem dhe unë që të shikojmë. Ka disa gjëra që duhen parë, jo këshilltar, jo kabineti, jo inspektorja, ajo që tha këtu për t’i rishikuar.

Jeni dakord? Kundër? Nuk ka.

Miratohet.

Në orën 12:00 kush dëshiron të jetë i pranishëm për të ndjekur debatin me shoqërinë civile nga Nënkomisioni Për të drejtat e Njeriut për gjakmarrjen, duhet të jetë në sallën e Konferencës së Kryetarëve.

Faleminderit!

E mbylлим sot mbledhjen. Javë të mbarë!